

VENDIM
Nr. 849, datë 26.12.2024

**PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 548, DATË 27.7.2016, TË KËSHILLIT
TË MINISTRAVE, “PËR MIRATIMIN E KRITEREVE, TË RREGULLAVE E
PROCEDURAVE PËR PËRFITIMIN E PENSIONEVE SHTETËRORE
SUPLEMENTARE TË PERSONAVE QË KRYEJNË FUNKSIONE KUSHTETUESE
DHE TË PUNONJËSVE TË SHTETIT”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 1, 15 e 17, të ligjit nr. 8097, datë 21.3.1996, “Për pensionet shtetërore suplementare të personave që kryejnë funksione kushtetuese dhe të punonjësve të shtetit”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. Në vendimin nr. 548, datë 27.7.2016, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime:

1. Në pikën 11 bëhen ndryshimet, si më poshtë vijon:

a) Në shkronjën “ç”, fjala “...zëvendësohet...” zëvendësohet me “...njësohet...”;

b) Shkronja “d” ndryshohet, si më poshtë vijon:

“d) Pozicionet e punës në drejtoritë e përgjithshme të bankave të nivelit të dytë dhe në ish-Institutin e Sigurimeve, nga “titullar institucioni” deri te “specialist”, njësohen me pozicionet homologe të institucioneve qendrore të grupit të tretë, të përcaktuara në vendimin përkatës të Këshillit të Ministrave për pagat e punonjësve në institucionet e administratës shtetërore.”.

2. Në pikën 13, fjalët “...në momentin e largimit nga funksioni...” zëvendësohen me “...në momentin e ndërprerjes së funksionit...”.

II. Ngarkohet Instituti i Sigurimeve Shoqërore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama